



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 2 dhe 8, lidhur me nenin 21, të Ligjit për financat e pushtetit lokal, Nr. 03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008”, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-108 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2016”, e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), lidhur me nenin 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, -----, miraton këtë;

## Projekt-V E N D I M

### Neni 1

1. Me këtë vendim të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitet e biznesit në Rr. **“Skënderbeu”** konkretisht nga rrethi të varrezat e qytetit deri të rrethi i hyrjes së autostradës (pjesa ku janë duke u kryer punimet e rrugës) dhe në Rr. **“Brigada 123”** konkretisht nga ura e madhe deri të ura e vogël, (pjesa ku janë duke u kryer punimet e sheshit), **LIROHEN** nga pagesa e taksës në aktivitetet për vitin 2024 dhe vitin 2025.
2. Lirimi nga taksa në aktivitetet bëhet vetëm për vitin fiskal 2024 dhe 2025 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër.
3. Në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e taksës në aktivitetet për vitin 2024, shuma e liruar i llogaritet si paradhënie për vitet 2026.

### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendim do të kujdeset Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet, përkatësisht Sektori i buxhetit dhe financave në Komunën e Suharekës.

### Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Me datë\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit  
\_\_\_\_\_  
Mr.ec Bexhet KUÇI